

Hapet thirrja për aplikim për bursa në programin Mevlana Exchange, për studentët dhe stafin akademik me kohë të plotë për mësimdhënie, për vitin akademik 2020-2021, në Universitetin e Trakya.

<https://www-en.trakya.edu.tr/>

Në kuadër të programit Mevlana Exchange është hapur thirrja për aplikim për bursa shkëmbimi për vitin akademik 2020-2021. Mevlana Exchange Programme është një program i cili mundëson shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik me kohë të plotë midis Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Trakya.

Studentët e nivelit bachelor, master dhe Ph.D. dhe stafi akademik me kohë të plotë nga Universiteti i Tiranës kanë mundësinë të aplikojnë në Universitetin e Trakya-s në Turqi për bursa shkëmbimi.

Kushtet e aplikimit për studentët:

- **Studentët që aplikojnë për periudhë shkëmbimi në Universitetin e Trakya duhet:**
 - Të jenë të regjistruar në Universitetin e Tiranës në programin bachelor, viti II, master viti I ose Ph.D.;
 - Studentët Bachelor të kenë një mesatare së paku 2,5 në një shkallë me 4 pikë;
 - Studentët Master dhe Ph.D. të kenë një mesatare së paku 3 në një shkallë me 4 pikë;
 - Të njohin gjuhën e mësimdhënies së departamentit në Universitetin e Trakya. Kini kujdes: Gjuha e mësimdhënies në Universitetin e Trakya për pjesën më të madhe të lëndëve është Turqishtja. Për departamentin e gjuhës angleze, gjermane, shqipe, greke dhe boshnjake gjuha e mësimdhënies është gjuha specifike;
 - Studentët duhet të kenë një certifikatë të gjuhës turke, angleze, gjermane etj. në varësi të programit të tyre të studimit.

Dokumentacioni për aplikim për studentët:

Dokumentat e nevojshme për aplikim mund të shkarkohen në seksionin “Candidate Student Application Form” në adresën <http://mevlana.trakya.edu.tr/>.

Konkretisht dokumentet që duhet të dorëzohen janë:

- Candidate Student Application Form:

(<https://mevlana.yok.gov.tr/en/Documents/Sayfalar/Documents/Candidate%20Student%20Application%20Form.docx>);

- Listë Notash dhe Vërtetim studentit në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën që do të ndiqet mobiliteti;

- Certifikata e Gjuhës;

Për më shumë informacion referohuni linkut:

<https://mevlana.trakya.edu.tr/pages/belgeler>

Kompensimi financiar për studentët:

- Bursa për studentët është 1300 TL (Turkish Lira) për çdo muaj.

Studentët e paguajnë pagesën e shkollimit në universitetin e vendit të tyre, pra ku ata janë regjistruar dhe nuk paguajnë asnjë pagesë tjetër shkollimi në universitetin pritës.

- Kostot e udhëtimit dhe akomodimit mbulohen nga vetë aplikantët.

Kushtet e aplikimit për stafin:

Stafi akademik i Universitetit të Tiranës:

- Stafi akademik kërkohet që të ketë aftësi të mira të gjuhës. (Gjuha e mësimdhënies në Universitetin e Trakya është Turqishtja, përveç disa departamenteve si ai i Gjuhës Gjermane, Shqipe, Angleze, Greke, Boshnjake).
- Dokumentacioni për aplikim përfshin dokumentin Academic Staff Mobility Programme:

<https://mevlana.yok.gov.tr/en/Documents/Sayfalar/Documents/Academic%20Staff%20Mobility%20Programme.docx>

-Dokumentacionet e tjera për aplikim, i gjeni në linkun:

<https://mevlana.trakya.edu.tr/pages/belgeler>

Kompensimi financiar për stafin:

- Kompensim ditor për stafin (45 - 55 TL/ditë);
- Biletë udhëtimi (3100 – 4600 TL)

Afati i aplikimit: 04 Mars 2020

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë nga e Hëna në të Enjte ora 10:30 – 11:30 dhe 14:30 – 16:00, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!